



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Prishtinë, 30 qershor 2025

Nr. 3

BULETINI INFORMATIV

Prill - Qershor 2025



SPORTI NË SHKOLLA – PRIORITET I PËRBASHKËT!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit dhe Federata e Sportit Shkollor të Kosovës kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi që synon fuqizimin e sportit në shkolla përmes qasjes shkencore dhe angazhimit praktik të studentëve tanë.

Ky bashkëpunim do të mundësojë grumbullimin dhe analizimin e të dhënave me bazë empirike, organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive shkollore, si dhe zhvillimin e projekteve që rrisin pjesëmarrjen dhe cilësinë në edukimin fizik në nivelin parauniversitar.

Studentët e FEFS do të jenë pjesë aktive në këtë proces – duke mësuar përmes veprimit dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në të ardhmen e sportit në shkolla.



FAKULTETI YNË NË QENDËR TË VËMENDJES NDËRKOMBËTARE – PARTNERITETI I PARË ME AKADEMINË SPORTIVE TË MALIT TË ZI NIS ME SUKSES!

Konferenca e 22-të Vjetore Shkencore e Akademisë së Sportit të Malit të Zi, me temën “Sport, Physical Activity and Health: Contemporary Perspectives”, ka nisur me sukses më 3 prill 2025 në Cavtat, Dubrovnik – Kroaci.

Për herë të parë, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit i Universitetit të Prishtinës është partner zyrtar në këtë ngjarje të rëndësishme shkencore, ku po marrin pjesë studiues dhe profesionistë nga vende të ndryshme të rajonit dhe më gjerë. Programi i konferencës përfshin prezantime shkencore, diskutime tematike dhe sesione poster, të cilat trajtojnë sportin, aktivitetin fizik dhe shëndetin nga perspektiva bashkëkohore.

Ky partneritet shënon një hap të rëndësishëm drejt ndërkombëtarizimit dhe rritjes së ndikimit akademik të fakultetit tonë në arenën ndërkombëtare, duke dëshmuar përkushtimin tonë ndaj zhvillimit të dijes dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.





INSPIRE – NJË HAP I RI PËR KËRKIMIN DHE INOVACIONIN NË SPORT

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, me mbështetje nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, në kuadër të thirrjes University Support Grants Program, të administruar nga KUSA, është fitues i projektit INSPIRE – Innovation in Sports Performance, Integration, Research, and Education, me synim të qartë: ngritjen e cilësisë së edukimit, kërkimit shkencor dhe shërbimeve profesionale në fushën e sportit dhe shëndetit në Kosovë.

Në kuadër të këtij projekti, Fakulteti do të:

- ✓ Pajisë Institutin e Shkencave të Sportit me pajisje të standardit të fundit, për analiza dhe matje të avancuara në sport dhe shëndet.
- ✓ Trajnojë stafin dhe studentët për përdorim dhe administrim të pajisjeve dhe laboratorëve modernë.
- ✓ Krijojë mundësi reale për kërkime shkencore, aktivitete ndërdisiplinare dhe zhvillim profesional.
- ✓ Ofrojë shërbime për sportistët dhe komunitetin përmes testimeve, monitorimit të performancës dhe programeve të rehabilitimit.

INSPIRE do të jetë motor i ri i zhvillimit të sportit dhe shëndetit në vend, duke ndihmuar studentët, sportistët dhe profesionistët të arrijnë më shumë!



PËR HERË TË PARË THEMELOHET SHOQATA ALUMNI NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

Me datën 14.04.2025 është mbajtur mbledhja konstituive e Shoqatës Alumni të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, ku u aprovua statuti bazë dhe u konstituuan organet udhëheqëse të shoqatës.

Faleminderit nga zemra të gjithë ish-studentëve që morën pjesë dhe kontribuan me ide dhe përkushtim për të ndërtuar një rrjet të fuqishëm që do të mbështesë studentët aktualë dhe ata të ardhshëm!

Në këtë Asamble të parë u zgjodhën këto organe udhëheqëse të shoqatës:

Kryetar i Bordit:

Astrit Haliti

Anëtarët e Bordit:

Valentina Maksutaj, Katrina Feka Gjaka, Drin Ferataj, Nehat Selmanaj, Elona Kolgeci, Gani Germizaj, Diellza Kelmendi Shaqiri, Arjana Govori Llagjaj.

Shoqata Alumni synon të krijojë një urë të qëndrueshme bashkëpunimi mes brezave të studentëve, për të ndarë përvojën, për të ndihmuar në zhvillimin profesional dhe për të forcuar lidhjen me Fakultetin.

Për të gjithë ata që nuk patën mundësi të jenë prezent këtë herë - ju ftojme që të na bashkoheni në takimin e ardhshëm. Kontributi i secilit prej jush ka vlerë të madhe!





ORGANIZOHET AKADEMI PËRKUJTIMORE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË PROFESORIT PROF.ASOC.DR. AZIZ DUJAKA

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit organizoi akademi përkujtimore në nderim të Prof. Asoc. Dr. Aziz Dujakës, me prezencën e shumë kolegëve dhe miqve, jo vetëm nga Kosova, por edhe nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.

FEFS në mbledhjen komemorative, shënoi një ditë zie dhe pikëllimi për të nderuar jetën dhe veprën e të ndjerit Profesor Aziz Dujaka.

Profesor Aziz Dujaka, pas një sëmundjeje të shkurtër, ndërroi jetë më 22 prill 2025.

Dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Prof. Asist. Florian Miftari, në fjalën e tij në akademinë përkujtimore, shpalosi jetën dhe veprën katër dekadëshe akademike të Profesor Dujakës. "Profesor Azizi shquhej si i dalluar në shumë sporte: gjimnastikë, not, tenis, ski, kërcim në ujë, alpinizëm, etj."

Dekani shtoi se Profesor Dujaka, si pedagog në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit për 40 vite, mbetet një shtyllë e dijes dhe një shembull i profesionalizmit të një profesori model.

Në emër të familjarëve, me një fjalë rasti falënderoi vëllai i të ndjerit, z. Esat Dujaka.



BASHKË PËR STUDENTËT – TRADITA E RE E BASHKËPUNIMIT PO VAZHDON FUQISHËM

Sot, në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, u ndanë 8 bursa studentore, në një ngjarje që simbolizon shumë më tepër se ndihmë financiare – simbolizon përkushtim, vlerësim dhe një partneritet të ri që po forcohet çdo ditë. Këto bursa u ndanë falë mbështetjes së katër federatave kryesore sportive në vend:

- z. Arben Fetahu – Federata e Basketbollit të Kosovës
- z. Edin Kolgeci – Federata e Hendbollit të Kosovës
- z. Bahri Gjinovci – Federata e Volejbollit të Kosovës
- z. Musa Selimi – Federata e Sporteve Universitare të Kosovës

Faleminderit nga zemra për këtë akt domethënës!

Ju nuk po mbështesni vetëm individë – po fuqizoni një gjeneratë të tërë që synon të bëjë ndryshimin në sport dhe në shoqëri.

Fakulteti ynë ndjehet krenar që kjo traditë e re e bashkëpunimit po vazhdohet me kaq shumë forcë dhe përkushtim.

Bashkë, po ndërtojmë ura të qëndrueshme mes dijes dhe sportit – për një të ardhme më të ndritur.

Faleminderit që po qëndroni përkrash nesh!





FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT VAZHDON TË ZGJEROJË MUNDËSITË PËR ZHVILLIMIN PRAKTIK DHE SPORTIV TË STUDENTËVE TANË!

Falë bashkëpunimit të frytshëm me Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës (FSUNK), studentët tanë po shfrytëzojnë hapësira të fakultetit për të praktikuar sporte si: Basketbolli, Beach Volley, Tenisi, Futsall dhe Ping Pongu.

Ky bashkëpunim është dëshmi e përkushtimit tonë që secili student të ketë qasje në infrastrukturë cilësore dhe kushte optimale për të zhvilluar aftësitë fizike dhe sportive, jo vetëm në teori por edhe në praktikë.

📌 FEFS mbetet një vend ku sporti, arsimi dhe përvoja e drejtpërdrejtë ecin dorë për dorë.



NJË SIMBOL I RI, NJË IDENTITET I PËRBASHKËT!

Me krenari ju prezantojmë logon e re të Shoqatës së Alumnit, një simbol modern që pasqyron trashëgiminë tonë, lidhjen me institucionin dhe vizionin për të ardhmen.

Kjo logo e re nuk është vetëm një pamje vizuale – është një shenjë e bashkimit tonë si komunitet, një urë mes të kaluarës dhe të ardhmes, një frymë që fton për bashkëpunim, angazhim dhe zhvillim të vazhdueshëm.

Ju ftojmë ta ndani këtë moment me ne dhe të bëheni pjesë aktive e aktiviteteve që po vijnë.



FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT KA VAZHDUAR ME KAMPANJËN INFORMUESE DHE BASHKËBISEDUESE ME MATURANTËT.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit ka vazhduar me kampanjën informuese dhe bashkëbiseduese me maturantët. Së bashku me studentët tanë, vizituam maturantët e dy shkollave të mesme në qytetin e Pejës: Gjimnazin "Bedri Pejani" dhe Shkollën e Mesme të Mjekësisë.



Shprehim mirënjohjen dhe falënderimin tonë për Shoqatën e Pedagogëve të Sportit Shkollor në Komunën e Pejës, si dhe për drejtorët dhe mësuesit e këtyre shkollave për mikpritjen e ngrohtë dhe të përzemërt.

Në kuadër të kampanjës është vizituar Gjimnazi "Hajdar Dushi" në qytetin e Gjakovës, SHMT "ANTON ÇETTA" në Skenderaj, Gjimnazi "Ulpiana" dhe Shkolla e Mesme Profesionale "Adem Gllavica" në Lipjan.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit i Universitetit të Prishtinës po vazhdon me intensitet fushatën promovuese në shkollat e mesme të Kosovës, duke informuar maturantët për mundësitë e studimit në fushën e sportit dhe edukimit fizik.

Faleminderim i veçantë për stafin e shkollës për bashkëpunimin dhe mikpritjen.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit - një adresë e saktë për pasionin dhe të ardhmen profesionale në sport!



SUKSES I JASHTËZAKONSHËM I STUDENTES SONË, DONJETA SADIKU!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës shpreh urimet më të përzemërta për sportisten dhe studenten tonë të dalluar, Donjeta Sadiku, e cila ka shkëlqyer në arenën ndërkombëtare duke fituar medaljen e artë në Kupën Botërore të boksit "Feliks Stamm", të mbajtur në Varshavë të Polonisë.

Në finalen e këtij turneu prestigjioz, Donjeta triumfoi ndaj boksieres britanike Elise Glynn, duke u shpallur kampione në kategorinë deri në 60 kilogramë. Ky sukses është një dëshmi e përkushtimit, disiplinës dhe punës së palodhur që ajo ka treguar në rrugëtimin e saj sportiv.

Arritjet e Donjetës janë një frymëzim për të gjithë studentët tanë dhe për komunitetin sportiv në Kosovë. Ajo vazhdon të jetë një ambasadore e denjë e vlerave që promovon Fakulteti ynë dhe Universiteti i Prishtinës.

Donjeta, ne jemi krenarë që je pjesë e familjes sonë akademike. Na ke bërë të gjithë neve – fakultetin, universitetin dhe gjithë Kosovën – jashtëzakonisht krenarë.

Të urojmë suksese të mëtejshme në rrugëtimin tënd drejt Lojërave Olimpike dhe jemi të bindur se je shembulli më i mirë se si sporti, edukimi dhe përkushtimi ecin bashkë drejt majave!

Me respekt dhe krenari,

Stafi dhe studentët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit

Universiteti i Prishtinës



MIRËNJOHJE PËR STUDENTËT BURSISTË!

Në një ceremoni të veçantë, Dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Prof. Asst. Florian Miftari, ndau mirënjohje për studentët përfitues të bursës universitare, në shenjë vlerësimi për përkushtimin dhe suksesin e treguar gjatë studimeve.

Urimi i dekanit Prof. Asst. Florian Miftari:

"Ju jeni shembull i përkushtimit dhe punës së palodhur. Këto bursa janë dëshmi e cilësisë suaj si studentë. Ju uroj shumë suksese në rrugëtimin tuaj akademik dhe profesional. Fakulteti është krenar për ju!"

Ky është një hap i rëndësishëm në motivimin dhe mbështetjen e studentëve që shquhen për arritjet akademike dhe angazhimin e tyre në jetën studentore.

Urime të gjithë bursistëve – suksese të mëtejshme në rrugëtimin tuaj akademik dhe profesiona



MBAHET ME SUKSES SEMINARI ONLINE NË KUADËR TË PROJEKTIT SHAPE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

Në seminar ligjëruan profesorë ndërkombëtarë të njohur si Harald Tschan, Barbara Wessner dhe Robert Csapo, të cilët ndanë njohuri dhe përvoja në edukimin fizik dhe shkencat e sportit. Temat kryesore trajtuan "Age Groups: Healthy Adults - Growth and Developmental - Aging the Elderly," duke treguar qasjet më të fundit për promovimin e shëndetit fizik gjatë gjithë ciklit të jetës.



PRAKTIKA NË LËNDËN E VALLËZIMIT

Studentët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit performojnë me pasion, përkushtim dhe energji në lëndën e vallëzimit - duke treguar jo vetëm talentin e tyre, por edhe fuqinë që ka arti për të na bashkuar. Këto momente janë frymëzim për të gjithë ne.



MBAHET ME SUKSES PRAKTIKA E FUSHIMIT BREGDETAR!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit ka realizuar me sukses fazën bregdetare të fushimit praktik, ku studentët tanë kanë zhvilluar ushtrime intensive në ambient detar – duke përfshirë notin, stërvitjet funksionale, aktivitetet grupore, si dhe ushtrime të veçanta me kajak, stand-up paddle dhe rafting.

Nën mbikëqyrjen profesionale të stafit akademik, çdo aktivitet është realizuar në përputhje të plotë me standardet e sigurisë dhe programin mësimor. Fushimi bregdetar nuk është vetëm pjesë e programit akademik – ai është një përvojë gjithëpërfshirëse që nxit zhvillimin fizik, bashkëpunimin dhe përballjen me sfida reale në natyrë.

Në FEFS nuk ndjekim vetëm orë mësimi – ne ndërtojmë kujtime, kapërcejmë limite dhe e jetojmë pasionin për sportin. Këtu, përjetohet kënaqësia e vërtetë e jetës studentore!



KRENAR ME STUDENTËT TANË TË JASHTËZAKONSHËM!

Me një atmosferë festive dhe entuziazëm të jashtëzakonshëm, u përmbyllën Ligat Universitare 2025, të organizuara nga Federata e Sporteve Universitare të Kosovës (FSUNK).

Në këtë ngjarje madhështore, morën pjesë rreth 600 studentë nga universitete dhe kolegje të ndryshme të vendit – dhe studentët tanë të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit (FEFS-UP) dolën triumfues, duke zënë vendet e para në disa disiplina!

Një sukses që na bën krenarë dhe na motivon për më shumë!

FEFS



NJË TJETËR HAP DREJT PROMOVIMIT TË SPORTIT GJITHËPËRFSHIRËS!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit i Universitetit të Prishtinës zyrtarizon një bashkëpunim të ri strategjik me Olimpiadën Speciale të Kosovës!

Ky partneritet reflekton përkushtimin tonë për të ndërtuar një shoqëri më të barabartë, ku sporti dhe edukimi fizik bëhen ura të fuqishme për përfshirje, zhvillim dhe fuqizim social.

Çfarë synojmë me këtë marrëveshje?

- ◆ Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta edukative dhe sportive;
- ◆ Ofrimin e praktikave profesionale për studentët tanë;
- ◆ Organizimin e trajnimeve, seminareve dhe fushatave për ndërgjegjësim;
- ◆ Nxitjen e vlerave të përfshirjes, diversitetit dhe barazisë përmes sportit.

Bashkë për një shoqëri ku sporti është për të gjithë!

Ky bashkëpunim është një tjetër dëshmi e misionit tonë për të avancuar jo vetëm njohuritë profesionale të studentëve, por edhe për të kontribuar në ndërtimin e një komuniteti më të drejtë dhe gjithëpërfshirës.



SALLA E FEFS ME PAMJE DHE FUNKSIONALITET TË RI!

Falë bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS) dhe Federatës së Volejbollit të Kosovës, si dhe kontributit të veçantë të kryetarit z. Bahri Gjinovci, salla e FEFS ka marrë një pamje moderne, funksionale dhe tërësisht të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.

Kjo sallë, përveç që ofron kushte të shkëlqyera për procesin mësimor dhe aktivitete sportive, tashmë është e gatshme edhe për organizimin e konferencave shkencore, trajnimeve, seminareve dhe ngjarjeve të tjera akademike e sportive, duke e bërë atë një hapësirë multifunkionale në shërbim të studentëve, stafit dhe komunitetit të sportit në vend.



ME BLENDIN – STUDENTIN QË NDRYSHOI IMAZHIN E FAKULTETIT!

Sot realizuam një foto të veçantë me Blendi Kallabën, studentin tonë të jashtëzakonshëm – krijuesin e palodhshëm pas imazhit modern të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit.


Pas dhjetëra videove, qindra fotografive, dhjetëra dizajneve dhe pafund ideve kreative, Blendi ka qenë forca e qetë dhe zëri i padukshëm pas skenës, që e ka transformuar dukshëm paraqitjen tonë publike. Ai nuk ka qenë vetëm pjesë e procesit – ai ka qenë motorri i tij, duke e udhëhequr me pasion, përkushtim dhe profesionalizëm.

Faleminderit, Blendi! Për çdo ide të guximshme, për çdo detaj të realizuar me dashuri dhe për çdo kontribut që ka lënë gjurmë. Fakulteti ynë është krenar me ty – dhe historia jote është tashmë pjesë e historisë sonë.



Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni :

 fefs@uni-pr.edu

 +383 38 243 747



Copyright (C) 2025 Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit
Universiteti i Prishtinës